



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 379 prot.

Tepelenë, më 19.02.2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

**KËSHILLTARËVE TË BASHKISË**

**Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. GRAMOS SAKO**

**Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.**

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e enjte më datë 26.02.2026, ora 11:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”, me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 29.01.2026, 13.02.2026.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2026”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2026”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2025”.
6. **Projektvendim:** “Për detajimin e plan–buxhetit për fondet nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale, granti të bazuar në performancë me burim financimi buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta të trashëguara nga viti 2025”.
7. **Projektvendim:** “Për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të fondit nga granti i bazuar në performancë për vitin 2025, me burim financimi të huaj”.

8. Raporti i performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2025.
9. Çështje të tjera.
10. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**



**Arben GUMENI**